



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr. FFF Prot., Datë 12.03.2019



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Nr. 1405 Prot., datë 12.03.2019

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

"Për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore që do të zhvillohen në datë 30.06.2019"

Mbështetur në Dekretin nr.10928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, më 30.06.2019 do të zhvillohen Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore;

Mbështetur në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe merr masa e organizon edhe programe për edukimin zgjedhor të shtetasve;

Mbështetur në ligjin nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", prokuroria ushtron ndjekjen penale, dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.

Mbështetur në ligjin nr.7905 datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

Mbështetur në ligjin nr.7895 datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

Mbështetur në ligjin nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që kanë zgjedhjet, për të ardhmen dhe integritimin e vendit në Bashkimin Evropian;

Duke marrë parasysh faktin se për integritetin e zgjedhjeve në Shqipëri, parandalimi dhe ndëshkimi i veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, ka një rëndësi të madhe;

Të bindur se për realizimin e standardeve kërkohet bashkëpunim serioz dhe i vazhdueshëm midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë, me qëllim përmbushjen në shkallë institucionale të këtij bashkëpunimi;

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
dhe
Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë

nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi:

I. Detyrimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr përsipër dhe garanton:

- a) të zhvillojë sesione trajnimi për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve për aktorët kryesorë të përfshirë në procesin zgjedhor;
- b) të zhvillojë fushata sensibilizuese për edukimin e shoqërisë, me synim njohjen e ligjit, parandalimin dhe denoncimin e veprave penale që prekin sistemin e zgjedhjeve;
- c) kur bën kallzim penal për veprat penale në lidhje me zgjedhjet, veçanërisht për raste të konstatuara apo të denoncuara për korrupsionin në zgjedhje dhe përdorimin e parave të paligjshme gjatë fushatave zgjedhore nga subjektet zgjedhore, të bashkëpunojë me prokurorinë në hetimin e shpejtë dhe objektiv të çështjes. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vë në dispozicion të prokurorit të paktën informacionin dhe dokumentacionin që mund të disponojë lidhur me, gjeneralitetet dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit/subjektit zgjedhor të cilit i atribuohet fakti (kur është e mundur); identifikimin e zonës elektorale/qendrës së votimit ku dyshohet se është kryer vepra (nëse lidhet me veprën penale); datën në të cilën dyshohet se është kryer vepra; elementet thelbësore të faktit dhe veprën penale të dyshuar se është shkelur;
- ç) të dërgojë brenda afateve formularët e vetëdeklarimit dhe relacionin apo dokumentacionin shoqërues, nëse ka, për verifikim të thelluar, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

II. Detyrimet e Prokurorisë së Përgjithshme

Prokuroria e Përgjithshme garanton:

- a) hetimin dhe ndjekjen penale me përparësi e eficientë të të gjithë veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve si dhe të çdo vepre tjetër penale, e cila dëmton procesin zgjedhor;
- b) trajtimin me prioritet të kërkesave të KQZ-së për verifikim të thelluar në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
- c) të mbështesë dhe bashkëpunojë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për zhvillimin e fushatave sensibilizuese/edukuese si dhe sesioneve trajnuese për eliminimin e

praktikave negative e identifikimin e shkeljeve penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;

- ç) t'i dërgojë KQZ-së informacion statistikor për veprat penale që kanë lidhje me zgjedhjet, të nevojshme për analizat paszgjedhore për hartimin e planit të masave për parandalimin e tyre në të ardhmen.

III. Detyrime të Përbashkëta

Palët marrin përsipër:

- të shkëmbejnë informacion nëpërmjet pikave të kontaktit;
- të sigurojnë mbrojtjen dhe fshehtësinë e informacionit, provave, akteve dhe/ose të dhënave të tjera, deri në përfundim të hetimeve paraprake.
- të zhvillojnë aplikacione kompjuterike të përbashkëta për të ftuar të gjithë qytetarët për të denoncuar shkelje të ligjit ditën e zgjedhjeve.

IV. Personi i kontaktit

Palët brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Memorandumi do të caktojnë nga një person kontakti që do të kujdeset për zbatimin e tij.

V. Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga palët.

Ky Memorandum Bashkëpunimi përpilohet në 2 (dy) kopje dhe secila palë mban nga një kopje të njëjtë.

Për
Prokurorinë e Përgjithshme

Arta MARKU


PROKUROR I PËRGJITHSHËM



Për
Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Klement ZGURI

KRYETAR



Tiranë, më 12.03.2019